



## FEDERATA SHQIPTARE E MOTOÇIKLIZMIT

### RREGULLORE E PËRGJITHSHME E KAMPIONATIT "SUPERMOTO 2023".

#### Cilësime

- Federata Shqiptare e Motoçiklizmit organizon Kampionation Kombëtar "SuperMoto 2023".
- Kampionati në **Edicionin 2023** do të përbëhet nga katër Raunde dhe 13 gara.
- Çdo garë ka sistem pikësh. Piloti **Kampion Kombëtar "Supermoto 2023"** do të shpallet nga shuma e pikëve të marrë në garat që ka marrë pjesë.

#### 1. Të përgjithshme

Raundi, i cilësuar si i tillë që organizohet në një fundjavë ose në një ditë, përfshin të gjitha garat, provat ose garat e suportit brenda saj.

Gara, pjesë e raundit, fillon në momentin e përcaktuar në axhendën e eventit dhe përfundon 30 minuta pasi juria shpall rezultatin zyrtar.

#### 2. Klaset

- Të gjitha klaset pjesëmarrëse do të jenë të klasës "FIM-Europe S2."

#### 3. Pilotët

- Të gjitha garat e Kampionatit janë të rezervuara vetëm për mbajtësit e një Licence Kombëtare Shqiptare gare të vlefshme për vitin 2023 në disiplinën "SuperMoto".
- Mosha minimale e lejuar e pilotëve pjesëmarrës është të lindur përpara datë 1 janar 2006.
- Çdo pilot e ka të detyruar veshjen mbrojtëse minimale: Helmetë, mbrojtëse për sytë, doreza, veshje mbrojtëse, çizme gare.

#### 4. Motori

- Motorët pjesëmarrës janë të klasit S2; midis 175cc deri 250cc dykohësh dhe midis 249cc dhe 449cc katërkohësh.
- Motorët jashtë kësaj kategorie do të mund të marrin pjesë në garë, do të marrin pikë për kampionatin, janë pjesë e renditjes së përgjithshme, por kanë edhe renditje të veçantë.

#### 5. Gjyqtaria

- Gjyqtaria e garës përbëhet nga:
  - Drejtuesi i eventit
  - Drejtuesi i garës.
  - Komisari teknik.
  - Juria sportive e kohëmatjes, numërimit dhe vendimmarrjes.
  - Komisarët e pistës
  - Kujdestarët e pistës
  - Mjeku i garës
- Vendimet e jurisë dhe rezultatet do të publikohen në një zonë rreth 20 m pranë vendndodhjes së saj dhe në website të federatës

#### 6. Penalizimet

- Sipas shkallës së shkeljes, do të jetë në gjykimin e Jurisë aplikimi i penalltive të mëposhtme:
  - paralajmërimi
  - gjoba
  - heqje kohe ose pikësh
  - zbritje në renditje
  - skualifikim
  - "STOP and GO" penallti
  - pezullim për garën e ardhshme
  - pezullim Licence

#### 7. Numrat e garës

- Numri i garës është unik dhe i njëjtë për gjithë kampionatin.
- Çdo garues do pajiset me tre numra ngjithës vjetorë.

#### 8. Regjistrimet

- Regjistrimi për çdo garë është i veçantë.
- Afati i fundit për regjistrim është 72 orë përpara fillimit të Raundit.
- Numri maksimal i pilotëve në garë do përcaktohet para Raundit.
- Në oraret e kontrollit administrativ, të gjithë pilotët duhet të paraqiten dhe të sjellin dokumentet e kërkuara specifikisht.
- Mosparaqitja në këto orare përbën skualifikim nga gara.
- Kontrolli teknik i mjeteve do të bëhet në orarin e caktuar dhe brenda zonës së parkimit.
- Pas kontrollit teknik, mjetet nuk mund të dalin më nga parkimi i caktuar.
- Dalja nga zona përbën skualifikim.

#### 9. Formati i Raundit

- Raundi do të zhvillohet në një fundjavë. Gjatë fundjavës do të zhvillohen katër gara. Dy gara ditën e shtunë pasdite dhe dy ditën e diel paradite.
- Ditën e shtunë do ketë dy seksione provash të lira nga 30 minuta secila. Dy seksione Warm Up. Pjesëmarrja e lirë. Një seksion kualifikues i kronometruar, Pole Position individual.
- Dy gara nga (x) xhiro. Numri i xhirove do të caktohet për një kohëzgjatje gare rreth 20 minuta.
- Secila garë është e pavaruar dhe ka pikavarazh më vete për kampionatin.
- Rradha e nisjes në garën e parë do të jetë sipas kohës së kronometruar në kualifikim. Rradha e nisjes në garën e dytë do të behet sipas inversit të rezultatit të garës së parë.
- Dita e dytë, e diel. Dy seksione Warm Up. Pjesëmarrja e lirë. Një seksion kualifikues i kronometruar, Pole Position individual.
- Rradha e nisjes në garën e tretë do të jetë sipas kohës së kronometruar në kualifikim. Rradha e nisjes në garën e katërt do të behet sipas inversit të rezultatit të garës së tretë.
- Që garuesi të mund të marrë pikë, duhet të startojë dhe të kryejë minimumi 1/2 e garës.
- Fituesit e Raundit do të marrin trofe. Fituesit e Raundit do të shpallen sipas shumës së pikëve të të katërta garave së bashku. Në rast pikavarazhi të barabartë, më lart në klasifikim do të jetë piloti me më shumë vende të para, ose të dyta, e me rradhë.

#### 10. Gara

- Zona e pritjes në start hapet 15 minuta para startit.
- Pesë minuta para startit mbyllet hyrja për në zonën e pritjes.
- Dy minuta para startit, venia e helmetave e detyruar, largimi i të gjithë asistentëve nga pista.
- Një minutë para startit mund të ndizen motorat.
- Motorat që nuk ndizen dot, kanë kohë deri në mbarimin e xhirove të nxehjes për t'u ndezur.
- Në sinjalin e drejtuesit të garës nisin dy xhiro e nxehjes.
- Në sinjalin e drejtuesit të garës, fillon gara. Sinjali është ulja e flamurit të kuq poshtë.
- Nisja e parakoshme penalizohet me një "Stop/Go" për pilotët që kanë kryer këtë shkelje.

#### 11. Sinjalet

- Sinjali: (kuptimi)
  - Karton i bardhë "4": (Katër minuta për start)
  - Karton i bardhë "2": (Dy minuta për start)
  - Karton i bardhë "1": (Lejohet ndezja e motorëve)
  - Karton i zi "STOP/GO" Shoqëruar me numrin e pilotit: (hyrje dhe dalje e detyruar nga bokset).
  - Karton jeshil "10": (Mbetur edhe 10 xhiro).
  - Karton jeshil "5": (Mbetur edhe 5 xhiro).
  - Karton i bardhë "Last lap": (Xhiro e fundit)
- Flamurët: (kuptimi)
  - Flamur i kuq: (Ndalim i garës).
  - Flamur i zi shoqëruar me numrin e pilotit: (ndërprerje e garës për pilotin).
  - Flamur i verdhë (i pavalvitur): (Rrezik. Pilot me kujdes)
  - Flamur i verdhë (i valëvitur): (KUJDES! Rrezik. Mbase duhet ndaluar. Jo parakalim. Mos kërce.)
  - Flamur i blu (i valvitur): (KUJDES! Pilot më i shpejtë po vjen. Je xhiro mbrapa. Krijohet lehtësi parakalimi).
  - Flamur jeshil: (Pistë e pastër).
  - Flamur bardhezi: (Finish).

#### 12. Pikët

- Shkallëzimi i pikëve për çdo garë:  
**25 pikë** - Vendi i parë  
**22 pikë** - Vendi i dytë  
**20 pikë** - Vendi i tretë  
dhe në vazhdim...**18/16/14/12/10/9/8/7/6/5/4/3/2/1**.  
Pole Position: **3 pikë bonus**

#### 13. Protestat

- Çdo pilot që ka një protestë, duhet ta depozitojë atë me shkrim menjëherë pranë jurisë.
- Brenda 30 minutash nga depozitimi i kërkesës Juria do të japë përgjigjen.
- Limiti kohor i ankesave është jo më vonë se 30 minuta pas publikimit të rezultatit final.

#### 14. Ceremonia e çmimeve

- "60" minuta pas shpalljes së rezultatit, zhvillohet ceremonia e ndarjes së çmimeve. Vendi i parë, i dytë dhe i tretë - marrin kupë.
- Në podium pilotët fitues duhet të jenë me veshjet e garës.

#### 15. Rregullore specifike

- Përpara çdo garë mund të ketë një seri rregullash specifike për Raundin përkatës.
- Këto rregulla do të mbivendosen mbi rregulloren e përgjithshme.

.....

Federata Shqiptare e Motoçiklizmit  
SuperMoto 2023